

SKELA SYLA sh.p.k

Pasqyra e Pozicionit Financiar për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe



Pasqyra e Pozicionit Financiar

| AKTIVET | Shënimi | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 |
|--|---------|---|---|
| Aktive afatshkurtra | | | |
| Mjete monetare | 4 | 6,185,074 | 13,962,737 |
| Llogari tregtare të arkëtueshme | 5 | 115,141,000 | 54,314,222 |
| Inventarë | 6 | 42,641,426 | 35,882,180 |
| Aktive të tjera | 7 | 1,506,759 | 4,577,653 |
| Totali i aktiveve afatshkurtra | | 165,474,259 | 108,736,792 |
| Aktive afatgjata | | | |
| Aktive afatgjata materiale | | 184,466,427 | 154,513,889 |
| Totali i aktiveve afatgjata | 8 | 184,466,427 | 154,513,889 |
| TOTALI I AKTIVEVE | | 349,940,686 | 263,250,681 |
| KAPITALI DHE DETYRIMET | | | |
| Kapitali | | | |
| Kapitali aksionar | 9 | 20,400,000 | 20,400,000 |
| Rezerva | 10 | 2,554,298 | 583,668 |
| Fitime të pashpërndara | | 21,921,517 | 10,871,517 |
| Fitimi i vitit | | 9,205,102 | 13,137,545 |
| Totali i Kapitalit | | 54,080,917 | 44,992,730 |
| Detyrime afatshkurtra | | | |
| Llogari tregtare të pagueshme | 11 | 75,358,903 | 15,368,288 |
| Llogari të tjera të pagueshme | 12 | 1,358,222 | 1,538,408 |
| Totali i detyrimeve afatshkurtra | | 76,717,125 | 16,906,697 |
| Detyrime afatgjata | | | |
| Hua bankare dhe të tjera | | 219,142,644 | 201,351,254 |
| Totali i detyrimeve afatgjata | | 219,142,644 | 201,351,254 |
| Totali i detyrimeve | | 295,859,769 | 218,257,951 |
| TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE | | 349,940,686 | 263,250,681 |

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga administratori i Shoqërisë më 31 Janar 2018 dhe janë firmosur nga:

Petrit Syla
Administrator

Hartues



SKELA SYLA sh.p.k

Pasqyra e Performancës për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Performancës

| | | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 |
|---|---------|---|---|
| Të ardhurat | Shënimi | | |
| Të ardhurat | 13 | 148,461,593 | 157,417,519 |
| Të ardhura të tjera | 13 | 1,275,000 | - |
| Kosto e mallrave të shitur | 14 | (99,007,526) | (84,821,190) |
| Shpenzime operative | 15 | (36,795,698) | (47,616,448) |
| Amortizimi | 8 | (1,762,418) | (8,647,228) |
| Shpenzime të tjera | 17 | (370,744) | (12,383) |
| Fitimi nga veprimtaritë e shfrytëzimit | | 11,800,207 | 16,320,271 |
| Shpenzime financiare, neto | 16 | (905,250) | (862,151) |
| Total i shpenzimeve financiare | | (905,250) | (862,151) |
| Fitimi para tatimit | | 10,894,957 | 15,458,120 |
| Shpenzimi për tatim fitimin | 18 | (1,689,855) | (2,320,575) |
| FITIMI NETO I VITIT | | 9,205,102 | 13,137,545 |

Pasqyra e performancës duhet të lexohet bashkë me shënimet në faqet 9 – 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave.

SKELA SYLA sh.p.k

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

| | Kapitali i nënshkruar | Rezerva ligjore | Fitime të pashpërndara | Totali |
|--|-----------------------|-----------------|------------------------|------------|
| Pozicioni financiar më 1 janar 2016 | 20,400,000 | 583,668 | 10,871,517 | 31,855,185 |
| Fitimi i vitit | | | 13,137,545 | 13,137,545 |
| Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse | | | - | - |
| Transaksionet me pronarët që regjistrohen direkt në kapital | | | | |
| Transferime ndërmjet zërave të kapitalit | | | | - |
| Shpërndarje dividendi | | | | - |
| Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016 | 20,400,000 | 583,668 | 24,009,062 | 44,992,730 |

Fitimi i vitit

| | | | | |
|--------------------------------------|--|--|-----------|-----------|
| Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse | | | 9,205,102 | 9,205,102 |
|--------------------------------------|--|--|-----------|-----------|

Transaksionet me pronarët që regjistrohen direkt në kapital

| | | | | |
|---|------------|-----------|------------|------------|
| Transferime ndërmjet zërave të kapitalit | | 1,970,630 | | 1,970,630 |
| Shpërndarje dividendi | | | (116,915) | (116,915) |
| Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017 | 20,400,000 | 2,554,298 | 31,126,619 | 54,080,917 |

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet bashkë me shënimet në faqet 9 – 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave.

SKELA SYLA sh.p.k

Pasqyra e Fluksit të Parasë për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Flukseve të Parasë

| FLUKSI I PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| Fitimi para tatimit | 10,894,957 | 15,458,120 |
| <i>Rregullime për:</i> | | |
| Zhvlerësim dhe amortizim | 1,762,418 | 8,647,228 |
| Ndryshime në: | | |
| - inventarë | (6,759,246) | 4,309,218 |
| - llogari të arkëtueshme | (57,755,884) | 22,144,978 |
| - llogari të pagueshme | 59,810,429 | (7,991,103) |
| Fluksi i parasë gjeneruar nga aktivitetet operative | 7,952,673 | 42,568,440 |
| - tatim fitimi | (1,689,855) | (2,320,575) |
| Fluksi i parasë neto gjeneruar nga aktivitetet operative | 6,262,818 | 40,247,864 |
| Blerje e aktiveve afatgjata materiale | (31,714,957) | (61,497,087) |
| Fluksi i parasë neto përdorur në aktivitetet investuese | (31,714,957) | (61,497,087) |
| FLUKSI I PARASË NGA AKTIVITETE FINANCUESE | | |
| Pagesa e huave | 17,791,390 | 33,418,539 |
| Divident i paguar | (116,915) | |
| Fluksi i parasë neto përdorur në aktivitetet financuese | 17,674,475 | 33,418,539 |
| Rritje neto në para dhe ekuivalentët | (7,777,663) | 12,169,317 |
| Para dhe ekuivalentët në fillim të vitit | 13,962,737 | 1,793,420 |
| Para dhe ekuivalentët në fund të vitit | 6,185,074 | 13,962,737 |

Pasqyra e glukseve të parasë duhet të lexohet bashkë me shënimet në faqet 9 – 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave.

SKELA SYLA sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Skela Syla Sh.p.k (“Shoqëria”) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Shkurt të 2008 me NUIS K81401024O dhe me adresë në qendër Kamëz, Tiranë, Shqipëri.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është prodhimi, montimi, çmontimi dhe qiradhënia e skelave. Gjithashtu Shoqëria përfshihet edhe në aktivitete të tjera të ndërtimit dhe tregtimit të materialeve të ndërtimit.

Më 31 dhjetor 2017, aksionari i vetëm i Shoqërisë është Z. Petrit Syla. Kapitali i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 është 20.400.000,00 LEK i përbërë nga 10 kuota me vlerë nominale prej 2.040.000,00 LEK secila.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyrat financiare, janë për qëllime të përgjithshme raportimi ligjor dhe janë përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, të ndryshuar, dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në Shqipëri dhe të përmirësuara me efekt nga 1 janar 2015.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe ajo e matjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është njëkohësisht dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetarë në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në Lekë me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetarë në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit njihen përgjithësisht në fitime ose humbje.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

| Monedha | 31 Dhjetor 2017 | 31 Dhjetor 2016 |
|---------|-----------------|-----------------|
| 1 EUR | 132.95 | 135.23 |
| 1 USD | 111.10 | 128.17 |
| 1 GBP | 149.95 | 157.56 |

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiarë jo-derivative përbëhen nga të drejta të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente të tyre, llogari të financimeve të brendshme, llogari të pagueshme dhe detyrime ndaj palëve të lidhura.

Të gjitha aktivitet dhe detyrimet financiarë njohen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivative njihen siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiarë kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiarë çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë mbarojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiare (vazhdim)

Mjetet monetare dhe ekuivalentët t tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat bankare. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e të drejtaave të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjëndje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që të drejtat e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjonit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën e interesit efektiv.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e vlerësuar për mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, të drejtat e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme i përafrohen vlerës së tyre kontabël.

3.3 Aktivitet afatgjatë

Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzimet e lidhura drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra (përbërësit madhor) më vete të aktivitetit. Fitimet dhe humbjet në dispozicion të një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël të elementit dhe njihen për vlerën neto në zërin "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të aktivitetit nëse është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme të trupëzuara do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri.

Kostot e shërbimit të përditshëm të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Aktivet afatgjatë (vazhdim)

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën lineare për përmirësimet e ambjenteve me qira dhe duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për të gjitha aktivet e tjera, gjatë jetëgjatësisë së çdo pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale nga dita e parë e muajit pas muajit të blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së tyre të dobishme. Toka nuk amortizohet. Metodot e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi. Jeta e dobishme për periudhën aktuale është si më poshtë:

- | | |
|------------------------------|----------------------------|
| • Ndërtesa | vlera e mbetur me 5% |
| • Automjete | vlera e mbetur me 20% |
| • Pajisje Zyre & Informatike | vlera e mbetur me 20 – 25% |
| • Aktivet jomateriale | vlera e mbetur me 15% |

3.4 Zhvlerësimi

Aktivitet financiare

Aktivi financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidence objektive të zhvlerësimit si pasojë e një apo disa ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, të cilat kanë ndikim në flukset monetare që rrjedhin nga aktivi financiar dhe që mund të maten në mënyrë të besueshme.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar i matur me koston e amortizuar, llogaritet si diferencë mes vlerës së tij të akumuluar dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare, të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet e rëndësishme financiare testohen individualisht për zhvlerësim në mënyrë periodikë. Pjesa e mbetur e aktiveve shqyrtohen në grupime që kanë karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit.

Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse ky anulim lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje të ndodhur pasi është njohur kjo humbje. Për aktivitetet financiare të llogaritura me koston e amortizuar, anulimi njihet në pasqyrën e të ardhurave.

3.5 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat llogariten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe përfaqëson shumën e arkëtueshme për shitjen e mallrave në rrjedhën normale të biznesit, duke marrë parasysh skontimet dhe uljet e ofruara. Të ardhurat njihen kur ofrohen shërbimet.

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.6 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga kurset e këmbimit. Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet nga kurset e këmbimit.

3.7 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual i cili njihet në “Pasyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve”. Taktimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme për periudhën, duke përdorur normat e tatimore të aplikuara në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

3.8 Shpërblimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Kompania nuk bën provizione dhe nuk ka detyrime për pensionet e punonjësve mbi kontributet e paguara në Institutin Shqiptar të Sigurimeve Shoqërore. Kostot respektive në emër të kompanisë njihen në Pasyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, në momentin që ndodhin.

3.9 Vlerësimet dhe gjykimet e kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të mëvonshme që besohet të jenë të arsyeshme nën rrethanat aktuale.

Vlerësimet dhe hipotezat që mbartin riskun e shkaktimit të një rregullimi material në vlerat e mabrtura të aktiveve dhe detyrimeve për vitin e ardhshëm fiskal, janë të listuara më poshtë.

Taksat mbi të ardhurat

Kompania është subjekt i taksave mbi të ardhurat në Shqipëri. Për të përcaktuar nivelin e taksave të shtyra mbi të ardhurat nevojitet një gjykim i kujdesshëm. Ka një numër transaksionesh dhe llogaritjesh për të cilat një përcaktim përfundimtar i taksave është i pasigurt. Kompania njeh detyrimet për çështje të pritshme që lidhen me auditimin fiskal bazuar në vlerësimet nëse do të ketë taksa shtesë për t'u paguar.

SKELA SYLA sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

4. MJETE MONETARE

Paraja cash dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si vijon

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|--|------------------|-------------------|
| Para në arkë në LEK | 322,380 | 12,422,257 |
| Para në bankë në LEK | 579,644 | 1,240,043 |
| Para në bankë në monedhë të huaj | 5,283,050 | 300,437 |
| Totali i parasë në arkë dhe bankë | 6,185,074 | 13,962,737 |

5. LLOGARI TREGTARE TË ARKËTUESHME

Llogari tregtare të arkëtueshme në datë 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---------------------------------|--------------------|-------------------|
| Llogari të arkëtueshme, klientë | 115,141,000 | 54,314,222 |
| Totali | 115,141,000 | 54,314,222 |

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë të arkëtueshme nga klientët për kryerjen e shërbimeve dhe shitjen e mallrave dhe produkteve të tjera nga aktiviteti kryesor i Shoqërisë.

6. INVENTARË

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|-------------------------------------|-------------------|-------------------|
| Lëndë e parë dhe produkte në proces | 21,781,110 | 13,167,306 |
| Mallra për shitje | 20,860,316 | 22,714,874 |
| Totali | 42,641,426 | 35,882,180 |

7. AKTIVE TË TJERA

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---------------------------|------------------|------------------|
| Parapagime për furnizime | 834,162 | 4,577,653 |
| Tatim fitimi i parapaguar | 613,008 | - |
| Parapagime të tjera | 59,589 | - |
| Totali | 1,506,759 | 4,577,653 |

SKELA SYLA sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

8. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

| Aktivitet materiale | Makineri dhe pajisje | Mjete transporti | Skela dhe akserorë | Të tjera | Totali |
|-------------------------------|----------------------|--------------------|---------------------|--------------------|---------------------|
| <i>Kosto</i> | | | | | |
| Më 1 janar 2016 | 991,200 | 11,654,567 | 127,587,991 | 4,413,647 | 144,647,405 |
| Shtesa | 12,155,402 | 1,612,496 | 38,704,378 | 9,024,810 | 61,497,086 |
| Pakësime | - | - | - | - | - |
| Më 31 dhjetor 2016 | 13,146,602 | 13,267,063 | 166,292,369 | 13,438,457 | 206,144,491 |
| Shtesa | 1,663,892 | 3,019,698 | 35,789,741 | - | 40,473,331 |
| Pakësime | - | (2,112,496) | (150,000) | (7,078,041) | (9,340,537) |
| Më 31 dhjetor 2017 | 14,810,494 | 14,174,265 | 201,932,110 | 6,360,416 | 237,277,285 |
| <i>Zhvlerësim i akumuluar</i> | | | | | |
| Më 1 janar 2016 | (520,364) | (6,358,971) | (35,649,755) | (454,285) | (42,983,375) |
| Shpenzime për vitin | (1,568,685) | (1,247,243) | (5,092,564) | (738,736) | (8,647,228) |
| Pakësime | - | - | - | - | - |
| Më 31 dhjetor 2016 | (2,089,049) | (7,606,214) | (40,742,319) | (1,193,021) | (51,630,603) |
| Shpenzime për vitin | (107,490) | (891,411) | - | (763,517) | (1,762,418) |
| Pakësime | - | 582,163 | - | - | 582,163 |
| Më 31 dhjetor 2017 | (2,196,539) | (7,915,462) | (40,742,319) | (1,956,538) | (52,810,858) |
| <i>Vlera e mbartur</i> | | | | | |
| Më 31 dhjetor 2015 | 470,836 | 5,295,596 | 91,938,236 | 3,959,363 | 101,664,031 |
| Më 31 dhjetor 2016 | 11,057,553 | 5,660,849 | 125,550,050 | 12,245,437 | 154,513,889 |
| Më 31 dhjetor 2017 | 12,613,955 | 6,258,803 | 161,189,791 | 4,403,879 | 184,466,428 |

SKELA SYLA Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

9. KAPITALI I PAGUAR

Më 31 dhjetor 2017 aksionari i vetëm i Shoqërisë është Z. Petrit Syla. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 është 20.400.000,00 LEK i përbërë nga 10 kuota me vlerë nominale prej 2.040.000,00 LEK secila.

10. REZERVA

Me vendimin e ortakut të Shoqërisë të datës 20 qershor 2017, rezervat ligjore u arritën vlerën prej 2.554.298,00 LEK (2016: 583.668,00 LEK). Fitimet e pashpërndara më 31 dhjetor 2017 kanë një vlerë prej 31.126.619,00 LEK.

11. LLOGARI TREGTARE TË PAGUESHME

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---------------------------------|-------------------|-------------------|
| Llogari të pagueshme, furnitorë | 75,358,903 | 15,368,288 |
| Totali | 75,358,903 | 15,368,288 |

12. LLOGARI TË TJERA TË PAGUESHME

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|--------------------------------------|------------------|------------------|
| Kontributet shoqërore e shëndetësore | 255,105 | 295,837 |
| Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi | 4,550 | 2,600 |
| Tatimi i mbajtur në burim | 2,850 | 2,850 |
| Tatimi mbi fitimin | - | 111,153 |
| TVSH e pagueshme | 240,682 | 187,030 |
| Paga për punonjësit | 808,775 | 938,939 |
| Parapagime të marra | 46,260 | - |
| Totali | 1,358,222 | 1,538,408 |

13. TË ARDHURAT

Të ardhurat për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen nga sa vijon:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|-----------------------------------|--------------------|--------------------|
| Shitje mallrash dhe lëndë të parë | 9,629,924 | 6,781,900 |
| Shitje shërbimesh | 84,999,042 | 61,040,426 |
| Të ardhura nga qiraja | 25,168,147 | 50,890,857 |
| Prodhime skelash | 28,664,481 | 38,704,337 |
| Të ardhura nga shitja e aseteve | 1,275,000 | - |
| Totali | 149,736,593 | 157,417,519 |

SKELA SYLA Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

14. KOSTO E MALLRAVE TË SHITUR

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|--------------------|-------------------|-------------------|
| Gjëndja në fillim | 35,882,180 | 49,767,810 |
| Blerje gjatë vitit | 105,766,772 | 70,935,560 |
| Gjëndja në fund | (42,641,426) | (35,882,180) |
| Totali | 99,007,526 | 84,821,190 |

15. SHPENZIME OPERATIVE

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|------------------------------|-------------------|-------------------|
| Pagat e punonjësve | 13,340,334 | 16,896,723 |
| Shpenzime të tjera operative | 4,368,257 | 120,224 |
| Kontributet e sigurimeve | 2,229,690 | 2,812,168 |
| Energji, ujë, gaz, karburant | 6,181,956 | 11,199,170 |
| Mirembajtje dhe riparime | 5,581,213 | 5,923,408 |
| Asete të shitura | 1,275,000 | |
| Qira | 228,000 | 171,000 |
| Trajtime të përgjithshme | 1,214,646 | 5,210,102 |
| Shpenzime reklamash | 1,280,101 | 1,560,847 |
| Siguracione | 97,695 | 230,117 |
| Konsulenca | 282,500 | 2,647,000 |
| Telekomunikacioni | 275,673 | 437,327 |
| Sherbime bankare | 299,634 | 158,953 |
| Taksa, tarifa vendore etj | 141,000 | 249,410 |
| Totali | 36,795,698 | 47,616,448 |

16. SHPENZIME FINANCIARE

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|--|--------------------|--------------------|
| Fitime nga kurset e këmbimit | 290,660 | 317,156 |
| Humbje nga kurset e këmbimit | (100,549) | (132,935) |
| Totali i humbjeve nga kurset e këmbimit | 190,111 | 184,221 |
| Të ardhura nga interesat | 3,039 | 1,581 |
| Shpenzime për interesat | (1,098,400) | (1,047,952) |
| Totali i shpenzimeve për interesa | (1,095,361) | (1,046,372) |
| Shpenzime financiare neto | (905,250) | (862,151) |

SKELA SYLA Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2017

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

17. SHPENZIME TË TJERA

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|------------------------|-----------------|-----------------|
| Gjaba, penalitete etj. | 370,744 | 12,383 |
| Totali | 370,744 | 12,383 |

18. TATIM FITIMI

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---------------------------------|-------------------|-------------------|
| Fitimi para tatimit | 10,894,957 | 15,458,120 |
| Shpenzime të pazbritshme | 370,744 | 12,383 |
| Fitimi tatimor për vitin | 11,265,701 | 15,470,503 |
| Tatimi mbi fitimin 15% | (1,689,855) | (2,320,575) |
| Fitimi neto i vitit | 9,205,102 | 13,137,545 |

Shpenzimet e pazbritshme lidhen me shpenzime që sipas Ligjit Shqiptar nuk mund t'i zbriten llogaritjes së fitimit/humbjes së tatueshme.

Më poshtë paraqitet rakordimi i normës efektive të tatimit:

| | 31 dhjetor 2017 | Norma efektive tatimore | 30 dhjetor 2016 | Norma efektive tatimore |
|-------------------------------------|------------------|-------------------------|------------------|-------------------------|
| Fitimi për vitin | 10,894,957 | | 15,458,120 | |
| Tatimi mbi fitimin 15% | 1,634,243 | 15.00% | 2,318,718 | 15.00% |
| Shpenzime të pazbritshme | 55,612 | 0.51% | 1,857 | 0.01% |
| Totali i tatimit mbi fitimin | 1,689,855 | 15.51% | 2,320,575 | 15.01% |

19. NGJARJE PAS PERIUDHËS RAPORTUESE

Nuk ka ngjarje të rëndësishme të ndodhura pas datës së mbylljes së pasqyrave financiare që kërkon rregullime të pasqyrave financiare ose dhënie të shpjegimeve plotësuese për to.

Shoqëria SKELA SYLA
 NIPTI K814010240

Aktivët Afatgjatë Materiale me vlerë fillestare 2017

| Nr | Emertimi | Sasia | Gjendje 12/31/2016 | Shtesa | Pakesime | Gjendje 12/31/2017 |
|----|------------------------|-------|-----------------------|-------------------|------------------|-----------------------|
| 1 | Toka | | | | | |
| 2 | Ndertime | | | | | |
| 3 | MAKINERI PRODHIM SKELA | | 12,155,402 | 1,643,000 | | 13,798,402 |
| 4 | MAKINERI PAISJE | | 991,200 | 20,892 | | 1,012,092 |
| 5 | AA MATERIALE | | 13,438,457 | | 7,078,041 | 6,360,416 |
| 1 | MJETE TRANSPORTI | | 13,267,063 | 3,019,698 | 2,112,496 | 14,174,265 |
| 2 | SKELA DHE AKSESOR | | 17,857,992 | | | 17,857,992 |
| 3 | SKELA DHE AKSESOR | | 2,651,974 | 28,664,481 | | 55,184,229 |
| 4 | SKELA DHE AKSESOR | | 12,191,462 | 7,125,260 | 150,000 | 128,889,889 |
| | SHUMA | | 206,144,491 | 40,473,331 | 9,340,537 | 237,277,285 |

Amortizimi A.A.Materiale 2017

| Nr | Emertimi | Sasia | Gjendje 12/31/2016 | Shtesa | Pakesime | Gjendje 12/31/2017 |
|----|------------------------|-------|-----------------------|------------------|----------------|-----------------------|
| 1 | Toka | | | | | |
| 2 | Ndertime | | | | | |
| 3 | MAKINERI PRODHIM SKELA | | 1,406,327 | 107,490 | | 1,513,817 |
| 4 | MAKINERI PAISJE | | 682,722 | | | 682,722 |
| 5 | AA MATERIALE | | 1,193,021 | 763,517 | | 1,956,538 |
| 1 | MJETE TRANSPORTI | | 7,606,214 | 891,411 | 582,163 | 7,915,462 |
| 2 | SKELA DHE AKSESOR | | 6,958,426 | | | 6,958,426 |
| 3 | SKELA DHE AKSESOR | | 15,347,384 | | | 15,347,384 |
| 4 | SKELA DHE AKSESOR | | 18,436,509 | | | 18,436,509 |
| | TOTALI | | 51,630,603 | 1,762,418 | 582,163 | 52,810,858 |

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2017

| Nr | Emertimi | Sasia | Gjendje 1/1/2016 | Shtesa | Pakesime | Gjendje 12/31/2017 |
|----|------------------------|-------|---------------------|-------------------|------------------|-----------------------|
| 1 | Toka | | | | | |
| 2 | Ndertime | | | | | |
| 3 | MAKINERI PRODHIM SKELA | | 10,749,075 | 1,643,000 | 107,490 | 12,284,585 |
| 4 | MAKINERI PAISJE | | 308,478 | 20,892 | | 329,370 |
| | AA MATERIALE | | 12,244,882 | -7,078,041 | 763,517 | 4,403,324 |
| 1 | MJETE TRANSPORTI | | 5,660,849 | 907,202 | 309,248 | 6,258,803 |
| 2 | SKELA DHE AKSESOR | | 10,900,120 | -150,000 | | 10,750,120 |
| | SKELA DHE AKSESOR | | 11,172,364 | 28,664,481 | | 39,836,845 |
| 4 | SKELA DHE AKSESOR | | 103,478,120 | 7,125,260 | | 110,603,380 |
| | TOTALI | | 154,513,888 | 31,132,794 | 1,762,418 | 184,466,427 |

**ADMINISTRATORI
 PETRIT SYLA**

SHOQERIA SKELA SYLA
NIPT K814010240

IVENTARI MJETE TRANSPORTI DATE 31.12.2017

| | EMERTIMI | DATA E KONTRATES | VLERA |
|----|--------------------|-------------------------|--------------|
| 1 | KAMION AA437MF | 01.04.2009 | 500000 |
| 2 | KAMION TR 8142 L | 01.04.2009 | 500000 |
| 3 | KAMION 6403 U | 01.04.2009 | 500000 |
| 4 | KAMION TR 5093N | SKA LETRA | |
| 5 | AUTOVETURE AA002EE | VITI 2008 | 8354567 |
| 6 | AUTOMJET TR 6075T | 12.02.2010 | 900000 |
| 7 | AUTOMJET AA783CB | 31.12.2014 | 400000 |
| 8 | AUTOMJE AA244RP | 25/05/2017 | 742665 |
| 9 | AUTOMJE AA967SA | 31/05/2017 | 843262 |
| 10 | AUTOMJE AA195SB | 31/05/2017 | 843262 |
| 11 | AUTOMJE AA749BP | 04/09/2017 | 590509 |
| | SHUMA | | 14174265 |
| | | | |

ADMINISTRATORI
SHOQERISE SKELA SYLA
PETRIT SYLA